



INFORMACIONE TË SHKURTRA PËR Sigurimin shëndetësor për emigrantët

"NY State of Health" është një treg në internet për planet shëndetësore. Çdo njeri duhet ta vizitojë tregun për të parë çfarë ofron.

Nuk ka rëndësi se ku keni lindur. "NY State of Health" mund t'ju ndihmojë.



Në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov



Me telefon në numrin
1-855-355-5777

TTY
1-800-662-1220

Këtu jepen 4 gjëra të rëndësishme që duhet të dini për "NY State of Health"

1 Informacioni që na jepni nuk do të ndahet me të tjerë

Çdo gjë që i komunikoni "NY State of Health" dhe këshilluesve të tij është private. Informacioni që na jepni për t'u regjistruar në një plan shëndetësor nuk do të ndahet me askënd tjetër. Gjithashtu, ai nuk do të përdoret për asnjë qëllim tjetër.

2 Do të merrni ndihmë pavarësisht mënyrës se si ju apo familja juaj keni ardhur në këtë vend

Edhe nëse nuk jeni të pajisur me dokumente emigrantësh apo nëse pjesëtarët e familjes kanë ardhur në këtë vend në mënyra të ndryshme, ju duhet vetëm të plotësoni NJË APLIKIM për çdo individ. Dhe, pavarësisht statusit, do të mund të përfitoni mbulim shëndetësor të rregullt dhe urgjent të "Medicaid" për fëmijët tuaj (Child Health Plus).

3 Do të merrni ndihmë në shumë gjuhë

- Operatorët që u përgjigjen telefonave tanë flasin shumë gjuhë. Nëse nuk e flasin gjuhën tuaj, ata do të gjejnë një përkthyes për ju.
- Në komunitetin tuaj, kemi njerëz të trajnuar që flasin gjuhën tuaj. Nëse dëshironi, ata mund të vijjnë në vendin ku jetoni apo punoni.

4 Do të merrni ndihmë në forma të ndryshme

Ndihmën mund ta merrni nëpërmjet internetit, telefonit apo personalisht në komunitetin tuaj. Këshilluesit tanë të trajnuar do t'ju ndihmojnë në çdo hap të zgjedhjes dhe regjistrimit në planin shëndetësor.

- Në internet në adresën nystateofhealth.ny.gov
- Me telefon në numrin 1-855-355-5777, TTY: 1-800-662-1220